



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 15, datë 07.12.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10.10)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1.Novrus Rrokaj | 23.Aurora Qarri |
| 2.Klodian Xhyheri | 24.Vjola Xhafaj |
| 3.Simo Petromilo | 25.Grigor Dede |
| 4.Brikena Sika | 26.Simbol Pazaj |
| 5.Myzafer Elezi | 27.Besmir Brahimaj |
| 6.Atird Hoxha | 28.Alta Haluci |
| 7.Ervis Moçka | 29.Arsen Belaj |
| 8.Erëmal Arapi | 30.Elca Bezhani |
| 9.Englantina Imeraj | 31.Edlira Kapllanaj |
| 10.Endri Hyseni | 32.Elpinqi Mërkuri |
| 11.Ardian Musta | 33.Bujar Osmënaj |
| 12.Lorel Canaj | 34.Illir Aliaj |
| 13.Edison Kapaj | 35.Liljana Breshani |
| 14.Geron Gunbardhi | 36.Ledja Shollaj |
| 15.Gjergji Nika | 37.Anxhela Shenaj |
| 16.Frosina Qyrdeti | 38.Gëzim Çapoj |
| 17.Sokol Kushta | 39.Shkëlqim Leskaj |
| 18.Eglantina Aliaj | 40.Eda Begaj |
| 19.Evis Allushi | 41.Briseida Çakërri |
| 20.Roland Strakosha | |
| 21.Rajmonda Zoto | |
| 22.Eneida Vera | |

Mungojnë :

- 1.Vullnet Bilbilaj
- 2.Brikena Puka
- 3.Anisa Ceno
- 4.Jerina Dervishaj
- 5.Marsela Dashi
- 6.Mujo Shakaj
- 7.Dikens Bushaj
- 8.Arjan Isufi
- 9.Liri Dëma
- 10.Refie Laze



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 15/1, datë 07.12.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes të gjithëve!

Faleminderit që jeni të pranishëm në këtë mbledhje jashtë radhe. Në lidhje me ftesën e ardhur nga bashkia Korçë, thjesht për të qenë transparent, në lidhje me takimin e këshilltarëve bashkiakë me këshillin e bashkisë Korçë. Nisja do të bëhet në datën 22 dhjetor, vetëm 1 ditë ky takim dhe mos të spekulohet me këtë njoftim. Viojmë me paketën fiskale.

Z.Klodian Xhyheri – Për procedurë. Të futet në rendin e ditës dhe “Projekt - Rezoluta kundër dhunës së grave “ .

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka ardhur një propozim nga zonja Eglja Imeri, kryetare e aleancës së grave këshilltare.

Znj.Englantina Imeraj - Si aleancë e grave , jemi mbledhur, dhe padiskutim e kam vlerësuar personalisht propozimin e zotit Xhyheri, marrë shkas nga ajo ngjarje. Duke e diskutuar me gratë dhe vajzat e aleancës së grave këshilltare, mendoj që duhet të jetë më e plotë, më e kompletuar . Faleminderit.

Znj.Frosina Qyrdeti – Vazhdojmë me projektvendimin “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore “

Z.Klodian Xhyheri – Më duket komike kjo situatë. Paraqitëm një rezolutë herën e kaluar , e kam diskutuar dhe me kryetarët e grupeve. Ishte ngjarje e rëndë, nuk ka kuptim. Nëse nuk doni ta miratoni..hidheni në votim dhe votojeni . Jemi konsultuar dhe me kryetarin e grupit të PS.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Jemi të gjithë në një zë. Nëqoftëse aleanca e grave këshilltare , ka marrëtermin që jemi vonë dhe po e shtyjme , nuk jam dakort. Le ti japim një zë grave dhe vajzave të këshillit.

Z.Myzafer Elezi – Për procedurë. Bëhet fjalë për një rezolutë. Është e kompletuar, e shkruajtur mirë,..Në komisionin juridik u diskutua, ishte e parregullt, mungonte projektvendimi ...Duke qenë se ky projektvendim është bërë fakt dhe ka ardhur, mund ta hedhim në votim.

Mendoj ta ezaurojmë sot këtë draft rezolutë.

Znj. Alta Haluci – Jam N/Kryetare e Aleancës së grave këshilltare, nuk jemi mbledhur . Është mendimi i saj, në diskutim me koleget dhe shoqet e saj. Prandaj , le të ngrihen dhe të thonë gratë që nuk jemi mbledhur, jo ta fshijmëPër të njëjtën gjë që jemi dakort ...,le ta përpilonte

Z.Gjergji Nika - Jam pro kalimit të rezolutës. Të ndajmë një gjë. Nëqoftëse, duhet ta kalonim me urgjencë ..., juve jeni të parët të shkëputeshit nga faji ..

Znj.Englantina Imeraj – E nisa fjalën duke falënderuar zotin Xhyheri , për propozimin e bërë. Është një propozim, në bashkëpunim me Qendrën “Vatra” për një tubim, për të protestuar Nuk erdhi asnjë tjetër....Edhe pse pjesë e kësaj ngjarje ishte dhe kolegja jonë. Edhe po të kisha një të afërmin tim, do të kërkoja të zhvillohej një e tillë. Për takimin me gratë e aleancës që nuk është bërë Do të kërkoja mos të jepen ngjyime politike.

Z.Ervis Moçka – Është e vërtetë që kemi bërë konsultime kryetarët e grupeve. Është një material shumë i mirë. Aleanca e grave këshilltare , meqenëse kanë marrë një afat 16 ditësh, le ta respektojmë. Teksti është shumë i mirë, por të respektohet afati i tyre, le ta shohin dhe ato.

Z.Gjergji Nika – Ftoj zotin Moçka .Këtu ka një mospërputhje të gjërave. S’kanë për ti parë gjë tjetër. Zoti Moçka bashkë me kryetarët e tjerë, e panë dhe u vendos. Zoti Moçka le të marrë një vendim politik...të hidhet në votim.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Të miratojmë rendin e ditës me pikën, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore “

Z.Atird Hoxha – Është e tepërt. Është mbledhja e dytë që diskutohet . Meqenëse kryetari i grupit të PS, kërkonte kohë të njëhej, është njohur dhe është dakort. Zoti Moçka është kryetar grupi i PS dhe vendosi për këtë rezolutë që, është në rregull. Nuk e kuptoj motivin , pse duhet ta shtyjmë. Nëqoftëse, ju keni ndonjë arsye

Znj.Elpinqi Mërkuri - A diskutuat për procedurë, mbaro mendimin

Z.Atird Hoxha - Juve zonja kryetare , duhet të jeni e para për miratimin e kësaj rezolute..Ju duhet të çlirohëni, futeni në rend ditë, votojeni.

Projekt rezoluta është e miratuar nga kryetarët e grupeve.

Znj.Liljana Breshani – Propozoj, 15 minuta pushim, të gjitha gratë e aleancës së grave këshilltare të hartojnë në emër të aleancës . Duam ta bëjmë tani. Na takon ne si aleancë e grave..., 15 minuta pushim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mendoj të vazhdojmë me rendin e ditës, më pas me propozimet tuaja, zonja Liljana.

Votohet rendi i ditës.

Pro – 27 vota

Kundër – 9 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet rendi i ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 15/2, datë 07.12.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore , në Bashkinë Vlorë për vitin 2024”

Relacion nga drejtoritë përkatëse.

Znj.Anjeza Shiko – Sikurse jeni në dijeni , sot paraqesim projektvendimin për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024. Paketa fiskale është një dokument që i paraprin buxhetit të vitit 2024.

(Lexon bazën ligjore ku është mbështetur për hartimin e paketës fiskale .)

Dokumenti në vetvete nuk është dokument i ri,por ai ekzistuesi , ku administrata ka bërë ndryshime dhe propozime .

Qëllimi dhe objektivat :

Si,- Rikualifikimi i zonave të ndërtimit

-Ndarja e tarifës së pastrimit nga ajo e gjelbërimit dhe ndriçimit etj, dhe ndryshimet e propozuara, kanë për qëllim që të afrojnë klimë miqësore me biznesin, meqenëse jemi qytet turistik.,

-Reduktimin e informalitetit...Janë bërë takime me bizneset dhe operatorët turistikë.

-Efektet e pritshme, ndaj ndryshimeve të bëra.

-Transparencë ndaj bizneseve për tarifën e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit

-Rritjen e cilësisë së shërbimit të pastrimit, për largimin e mbetjeve

-Tarifë ndryshe për zënien e hapsirës publike(plazh) dhe tjetër për njësitë akomoduese..

Konkretisht për paketën fiskale të vitit 2024, kërkon rritje të taksës dhe tarifës ;

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë

-Tarifa për shërbimin e pastrimit, dhe largimit të mbetjeve

-Tarifa për parkim

-Tarifë për shërbimin për subjektet e ndërtimit

-Tarifa e biletave.....

Për taksën e ndikimit në infrastrukturë zoti Klaudio Mehmetaj.

Z.Klaudio Mehmetaj – Propozimet që kemi pasqyruar , janë nga takimet e bëra me anëtarët e këshillit dhe bizneset.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë që kemi që prej vitit 2019, ka të përcaktuara 2 fasha

1-Lungomare , 8%..Çmimi i shitjes nga ministria dhe, për zonat e tjera, fasha 4%.

Kjo taksë zë një peshë kryesore në të ardhurat e bashkisë.

Është ndarë në 3 fasha , bazuar në kërkesat për ndërtime në brendësi të qytetit.

Bashkia, ne kemi propozuar ti ndajmë në 3 fasha dhe konkretisht, në zona me 4%;6% dhe 8%

Vija e parë me pamje,

-1fasadë nga lungomarja

1-Fasha 8%, Uji i Ftohtë,zona Skelë – Tunel, objekte për qëllime turistike.

2-Objektet në rrugën Sazani – “Gjergj Kastrioti”, “Pelivan Leskaj “, fasha 6%. Këtu kemi dhe rrugën “Sazani “ në krahun e detit, 1 anë në fasadë , kjo është me 6%.

-Rruga Transballkanike , ka qenë 4% dhe bëhet 6%..

-Bulevardi “Ismail Qemali “, aktualisht është 4%, shkon në 6%

-Rruga “Pelivan Leskaj “ , nga 4% shkon në 6%

Nga Rruga “Pelivan Leskaj - Orikum ...Për mbledhjen e taksës së tabelës , zona Skelë – Tunel – 8%

Pikat 1/2 - Rruga “Sazani “- “Pelivan Leskaj “, përgjatë bulevardit , taksa ka ndryshuar në 6%

-Zvërnec dhe Kaninë , 4%, mbetet e pandrushuar.

-Shushicë, është 4% dhe nuk ka ndryshuar

-Novoselë – 4%.... Orikum, fshat Dukat etj .., prishja e pallateve të vjetra 4%.

-3% vlerë e investimit për të pastrehët

Në sektorin e bujqësisë 1% e vlerës së investimit.

-Njësi banimi në Vlorë, Orikum , taksa 3% e vlerës së investimit.

-Njësi banimi në zona të tjera 2%.

-Strukturat akomoduese - 0% e vlerës së investimit. Përfituese është bashkia , taksat “zero”

Pikat 1,4; 1,5; 1,6; 1,7, me çmimin e referencës. Për taksën e ndikimit në infrastrukturë,

Drejtoria e Urbanistikës ka propozuar duke, u nisur nga parja ose shikimi i një dokumentacioni të shumtë ..., tarifat e aplikimit për leje zhvillimore , nga 5 në 1000 lekë;

-Tarifë për certifikatë përdorimi, nga 5 në 1000 lekë,

-Ndërtesë për qëllime banimi nga 5 në 15 000 lekë ,

-Rishikim të tarifave në kantier ndërtimi..deri në muajin qershor, kontrolli nuk bëhej nga bashkia . Bazuar në ligj, kjo do të bëhet nga bashkia , që nga ngritja e kantierit...

-Tarifa për leje përdorimi nga 35 në 2 70 mijë lekë

Jemi duke hartuar punën dhe me EKB, për llogaritjen e taksës në infrastrukturë, mbi gjithë ndërtimin.

Z.Gjergji Nika – I ndajmë më mirë, urbanistikën nga taksat.

Znj.Anjeza Shiko – Është bërë një përmirësim në procedurën, në lidhje me rregjistrimin në hotele.

Z.Atird Hoxha – Mos thoni që ka ndryshuar.

Taksat janë 70 dhe 75 mijë lekë.

Znj.Anjeza Shiko - Kjo është bërë vetëm për bizneset që nuk pasqyrojnë rregjistrat..., jo për 1 , por për 2 persona.

-Tarifa e pastrimit është ndarë nga gjelbërimi dhe ndriçimi..

Sot kostot 17 % ..

63%subvencion, nga buxheti i bashkisë. Aktualisht fondi , në 64% i subvencionit, për pastrimin...

Në bashkëpunim me financën – 48% bizneset; 49% familjet..pjesa nga institucionet ..

Krahasuar dhe me bashki të tjera të së njëjtës kategori dhe më të ulët ..Ne e kemi tarifën më të ulët . Për kategorinë familje, s'ka asnjë ndryshim as për pastrimin, as gjelbërimin dhe ndriçimin. Propozimi për ndryshimin e tarifës për zënien e hapsirës publike, bazuar kjo në zhvillimin e dëgjësave me bizneset. Mbas dëgjësave të zhvilluara, ka ardhur një shkresë nga bizneset , ku kërkesat e tyre janë reflektuar .

Bizneset për plazhet, tarifa për sezonin , është ulur për periudhën 5,5 mujore.

-Tarifa e parkimit për bizneset ..Administrata ka propozuar nga 19 mijë në 30 mijë lekë.

-Propozim nga drejtoritë në varësi, tarifa për ekranin, për filmin..Pra, jo vetë qiraja e ambientit , por tarifa e ekranit është bërë 10 mijë.

-Institucionet sportive, nga 7 mijë në 10 mijë lekë.

-Konviktet , niveli nga 300 lekë/shtrat është bërë 500 lekë/shtrat.

Këto janë ndryshimet e bëra , ftojmë këshilltarët ..

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit. Flasin kryetraët e komisioneve..

Z.Ervis Moçka – Tek vërtetimi, për pronësinë në njësinë administrative, është rritur .

Është kërkesë e njësisë administrative ..

-Sa afekton kjo në buxhet ? A ka vlerë specifike, a ka mundësi të njehsohet?

Z.Gjergji Nika – Rritja e taksave, sa është impakti në buxhet ?

Znj.Anjeza Shiko - Taksa e ndikimit në infrastrukturë, vetëm kjo është rritur. Të tjerat janë tarifa.

-Tarifa e pastrimit , deri në 1 miliard

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë.....

Z.Klaudio Mehmetaj – 3,3 miliard/vjetra; 3 miliardë.. kemi përfshirë këtu dhe nga aplikimet në KKT dhe taksën e ndërtesës e presim ne.

Z.Gjergji Nika - Për 3,3 miliardë në 6 muaj ...Pse nuk ka arkëtime në 6-mujorin e dytë ?

Sa leje aktive , për tu ndërtuar mbi 21 kate

Z.Klaudio Mehmetaj – Duhet të marrin leje pranë KKT-së.

Z.Gjergji Nika – 6% me mbi 21 kate...leje..

Z.Atird Hoxha – Jo se kisha gjë të paqartë për këtë projektvendim, po kur kujtoj 1471 , këtë numër punonjësish..

Kam nxjerrë 6 prej rritjeve;

-Taksa e fjetjes në hotel, në pikën 1 që bëhet në 150 nga 120 për dhomë. Është ndarje , midis të cilës nuk e kuptoj, në lidhje me rregjistrin ?

-Fasha ka ndryshuar , ka qenë në 3 zona, është bërë në 5. Ka qenë në një ,segmentet më të shumta, pra 30% më shumë.

-Tarifa e parkimit; Tarifa e pastrimit; Tarifa për plazhet , janë rritur. Pra, do të rritet bara fiskale në xhepat e qytetarëve, kemi një rritje prej 40%.

Thatë që keni bërë takime me bizneset, por nuk e di kush janë ato biznese që mund të mbajnë apo të rriten taksat me 40%. Më konkretisht:

-Keni rritur taksën e ndikimit në infrastrukturë. Pra, thoni që i keni rritur taksat në të gjitha ...tek Porti, pse duhet të paguajë 6%...Është një zonë elitare që nuk e arrijmë ne. Pse mos ta paguajë 8%, sikurse ata që bëjnë kontratat me qytetarët. Jemi në fashën e 30-40% rritje.

-Tarifa e zënies së hapsirës publike – për biznesin ka pësuar një rritje.

Bulevardi ,Vlorë – Skelë , ka qenë 3 dhe 4 mijë

-Lungomarja , nga 3 , është bërë 5

-Qendra historike, është ndarë në dy fasha, ka rritje. Ka qenë 2 dhe 3, është bërë 3 dhe 4 mijë. Kemi pikën 7 të shtuar, që nuk e kemi patur në paketën e mëparshme. E kemi 5.500 dhe jo 4 mijë...Kjo ngelet në pjesën e inspektimit..Do ti masni në terren.

Znj.Anjeza Shiko – Po.

Z.Atird Hoxha - Tarifa për plazhin Nartë – Plazhi i Vjetër, ka qenë 4 mijë. Thoni për njësi akomoduese, është 3,4 mijë.

Pastaj keni bërë ndarje, stacionet e plazheve(90% e zënë), kemi rritje 30%

Në zonën e Lungomares , zënien e hapsirës së plazhit , keni bërë një ndarje tjetër, me një rritje 40-45%, ku plazhi është i ndotur.

Zënia e hapsirës publike të plazhit në lungomare ka ndryshuar (lexon) Pjesa kryesore, janë baret dhe restorantet, nga 5 në 7 mijë.

-Tarifa e shërbimit të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit...në atë që keni pës për bizneset , ka qenë tarifë fikse(paketa fiskale e mëparshme)

Sot thoni, keni bërë 3 ndarje..keni shtuar tarifën e ndriçimit, gjelbërimit për bizneset ...Këtu variojnë rritjet nga 30-40% të barës fiskale.

-Parkimi, vjet për subjektet është miratuar 190 mijë, shkon në 300 mijë lekë/vit, pra është rritur shumë. Janë taksa që paguajnë qytetarët.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Dhe unë jam qytetare.

Z.Atird Hoxha – Bara fiskale , i është rritur qytetarit.

Z.Shkëlqim Leskaj – Po flasim shumë për qytetarët. Buxheti i bashkisë, janë 2 zëra kryesorë, pra taksat dhe tarifat dhe granti nga qeveria. Duhet të kemi përmirësime në çdo fushë , si infrastrukturë etj, pra duhet të paguajmë taksa dhe tarifa.

Taksa e fjetjes në hotel, nuk kemi rritje. Ka ndryshuar vetëm për ato biznese, hotele që nuk deklarojnë rregjistrat, pra është një masë shtrënguese. , për ato biznese që nuk deklarojnë.

-Kemi tarifën për pastrimin, gjelbërimin, ndriçimin, vetëm për bineset në qytet. Jemi qytet turistik, pastaj duhet të bëhet më mirë...Ka kosto prandaj do të rritet dhe kjo taksë tek bizneset.

Të gjitha taksat dhe tarifat shpërblehen në shërbime për qytetarët.

Tarifa e zënies së hapsirës së plazhit, dhe këtu kemi ndryshim sipas zonave dhe, cilësia është e ndryshme. Pra, nga 2 është bërë në 3 zona.

-Flasim për parkimin. Kemi shumë subjekte që marrin leje për parkim , rritja nga 19 në 30 , është shumë e vogël, pasi ata zënë hapsirat publike.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë , ndryshuar nga 4% në 6%, nga rruga “Pelivan Leskaj “ tek Rrapi .

Për Rnga 4% në 6%

Porti – Plazhi i vjetër, nga 4% në 6%. Çmimet janë ngritur, janë dhe investimet nga qeveria shqiptare në infrastrukturë.

Kjo taksë të shihet. Siç tha dhe drejtori i urbanistikës, bazuar në ligj, ndryshimet e tarifave dhe taksave , sjellin dhe ca të ardhura në buxhetin e Bashkisë Vlorë, që kthehen në shërbime për qytetarët.

Znj.Anxhela Shenaj – Doja të dija, cili do ishte shërbimi më cilësor, në lidhje me tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit?

A janë bërë këto shërbime ? Çfarë po bëni ju që po rrisni tarifën për një shërbim më cilësor ...

Znj.Evis Allushi - Projektvendimi i paraqitur nga administrata është bazuar në ligje. Bashkia Vlorë, nuk ka dalë nga korrniza.., takimet me grupet e interesit duhet të ishin kryer më shpejt, lexon nenin.....paraqitur koha e konsultimeve, konstatova që tarifat janë vendosur në mënyrë Edhe pse duke e krahasuar me tarifat e mëparshme, ka rritje, por gjithmonë brenda korrnizës së ligjit.(Lexon, citon ligjin)

Tarifat për plazhet - Janë stimuluar hotelet, pasi çmimi i çadrës, është brenda çmimit të dhomës. I njëjti arsyetim dhe për parkimet.

Fabrika e Tullave – Transballkanike

Zona e dytë, tarifa të ngelet 19 mijë. Të ardhurat nuk janë njësoj në gjithë qytetin.

Mendojmë, duke marrë parasysh dhe gjykimin tim, ta miratojmë këtë projektvendim, që ti hapë rrugë buxhetit.

Z.Geron Gunbardhi – Projektvendimin e diskutuam dhe në komisionin e financës , nuk patëm Për ata që kanë ikur, për shpopullimin

-1 miliard të ujësjellësit, a do ti kthehen qytetarëve të bashkisë?

-Në lungomare , me rritjen e taksës së biznesit të vogël , deri në 2023, 3 herë., parkimi etj...

Pra, t'iu themi qytetarëve që, edhe pse po largohen, taksat dhe tarifat do rriten. Nga takimet me bizneset e Vlorës, dhe janë pasqyruar , thoni nga takimi me një numër të vogël

-Tokat e dhëna me qira, administrata vetëm fryhet ..

Të gjithë e duam qytetin të bukur.

Tek legalizimet, duhet të marrin 0,5% taksë , ndërsa qytetari i ndershëm, 3% plus tarifa të tjera.

-Për palzhet, keni rritur tarifën. Ku e kanë plazhin publik, qytetarët ?

Kjo bashki të mbledhë taksat e pambledhura, borxhin e ujësjellësit ...

Tarifat duhet ti shihni mirë. Rruga Transballkanike, është deri tek Fabrika e Tullave.

Z.Illir Aliaj – Dhe tek komisioni ynë , ky projektvendim kaloi. I bëmë vërrejtjet drejtoreshës, i morri në konsideratë. Mendoj që ky projektvendim të kalojë pasi është konformë rregullores dhe ligjeve.

Në lidhje me tarifën e zëniës së hapsirave publike, kjo tarifë është rritur për subjektet e mbyllura. Është bërë shumë mirë, që është vlerësuar kështu, dhe një tjetër që ka më pak sipërfaqe ndërtimi, ka marrë më shumë sipërfaqe jashtë.

Mendoj që, ky vlerësim nga kjo drejtori, është shumë e saktë, bile të rritet....

Klasifikimi, pra të përcaktohet tek tabela 5, nga 6 në 21....

Jo çdo lloj subjekti që paraqitet në Drejtorinë e Taksave , ka institucione që bëjnë ndotje akustike. Këto i paraqitëm dhe do ti relatojë drejtoresha.

Z.Ermal Dredha – Po flas në parim.Kemi bërë takime. Thirrja ka qenë për të gjitha bizneset, pavarësisht sa kanë ardhur, pra kemi pasur një dakortësi. Kemi dhe rritje të taksave dhe tarifave, çdo gjë për investime, ka kosto. Flas për pjesën tonë, për përmirësimin e shërimeve.

-Drejtoresha e gjelbërimit, ka kërkuar rritje të numrit të punonjësve. Qyteti vërtet që ka shumë fluks..., kështu rriten dhe kostot tona. Janë në projeksion për 10-vjetët e ardhshëm. Edhe qytetet e tjera, i kanë tarifat më të larta se ne. Ndërsa, çfarë përfiton bashkia..., për pjesën e bareve të mbuluar ...E kemi diskutuar dhe me grupet e interesit, pra ai me ambjent të mbyllur, e ka biznesin gjithë vitin. Ne na orjenton koha . S;kemi dhe ne dëshirë të rrisim taksat dhe tarifat, e kërkon koha.

Do marrë një vendim.

Znj.Alta Haluci – Jam konsultuar..., këtu u diskutua ...Taksa e fjetjes në hotel, do rëndohen subjektet akomoduese. Nëqoftëse, rritet taksa , ndikon dhe tek ne , tek turistët.

Rritja e taksës së hapsirave të plazheve..., nuk do ketë plazhe publike.

Krahasimi me qytetet e tjera, ashtu sikurse diskutohet për ujin me Korçën..., nuk më duket reale kjo pjesë.

Pjesa e plehrave, është shumë problem, çdo gjë bie në xhepat e qytetarëve të Vlorës.

Unë votoj kundër, sot.

Znj.Elca Bezhani – Siç e tha dhe zoti Geron, dokumenti u diskutua në komisionin e financës , ku është mbështetur në bazën ligjore, bashkëlidhur. Është bërë takimi me grupet e interesit, por para tyre, është bërë një grup pune dhe me kontabilistë dhe anëtarë të komisionit të këshillit bashkiak. Do citoja ligjin “Për financat vendore “ nr 68/2017, dhe qëllimi i këtij ligji, është të duke bërë transparencë për drejtimin e financave . Në nenin e ligjit, për financat vendore, nga konsultimet që janë bërë, kam vërrejtur që këto takime janë bërë , dhe grupet e kontabilistëve kanë dhënë mendimin e tyre.

Tarifa e pastrimit, dhe nga një analizë e KFW, deri në vitin 2030, do të mbulonte 80% të kostos. Sot kjo kosto nuk mbulohet, pra vetëm 37% dhe pjesa tjetër, nga bashkia. Rritje për abonentët familjarë, nuk ka .

Taksa e fjetjes në hotel, nuk kemi rritje. Po të shohim analizën që, hotelet të mbajnë rregjistrin e frekuentimit në hotele, në rast të kundërt do jenë punonjësit e taksave ..

Përsa i përket numrit të punonjësve të bashkisë , kemi rritje, pasi dhe territori i Bashkisë Vlorë është rritur, janë dhe 4 mijë...Ky 1471, nuk ka të bëjë vetëm me punonjësit e bashkisë , por dhe institucionet vartëse.

Taksat nuk janë rritur, përveç taksës së ndikimit në infrastrukturë, kërkohen shërbime më shumë. Ju kam kërkuar anëtarëve të këshillit bashkia, të monitorojmë punën e administratës. Me 17% mbulohet kosto e pastrimit. Bizneset e liçensuar, për ato biznese që veprojnë në mënyrë të paligjshme....Jemi kundër informalitetit. Mendoj që ky projektvendim të kalojë në këshill për miratim.

Z.Arsen Belaj – Ky projektvenim për taksat dhe tarifat vendore.., të gjithë e dimë që kjo bashki me taksa dhe tarifa mbahet. Do të doja që këta punonjës të tatimeve të dalin dhe nëpër njësi. Nuk ka njerëz. Nuk mund të vihen taksat dhe tarifat njësoj si në Lungomare. Të vini të shihni, po flas për taksat dhe tarifat në njësitë administrative . Zonat rurale, të kenë diferencime. Në Orikum, nuk ka plazh publik. Tarifa nga 5-7,5 lekë, të kthehen në shërbime. Problem në Orikum, kanalizimet e ujrave të zeza, mungesa e dritave. I them administratës, a mund të rishikohen taksat dhe tarifat në njësitë administrative ?

Znj.Anjeza Shiko – Është e diferencuar. Gjithë njësitë 200lekë/m², nuk kanë ndryshime, dhe jo vetëm, por dhe në të gjithë qytetin. Dyqani i mbyllur punon 12 muaj/vit.

Lungomarja në 100m² , për 2000euro/m²...5,5 euro/m²..Bazuar në ...

Z.Arsen Belaj – Të bëhen investime dhe tek ne.

Z.Gjergji Nika – E para, i uroj suksese bashkisë, që pas 10 vjetësh , hartoi një paketë fiskale. Paketa fiskale, është 50% e plotë , duhet të ishte më e saktë, është pak e nxituar.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë , për zonat në njësitë administrative, të ulej, pra mos të ishte 4%, por dhe 2% të bëhej. Tarifat janë rritur 37%..Pse paketën fiskale ,na i keni sjellë sot..Po të ishte bërë kohë pas kohe , nuk do kishim këtë rritje. -37% rritje të tarifës.

Përsa i përket studimit të KFW, kryetare e komisionit, bazuar në studimin deri në vitin 2030

...Rriten të ardhurat me 1,2 miliardë ...Keni rritur 70 veta, staf.

Z.Illir Aliaj – Do jetë shërbimi.

Z.Gjergji Nika – Ne e rritëm me 22 veta në shërbimin e varrezave.

Z.Illir Aliaj – Kërkuat që të krahasiten pemët, ku ti gjejmë, duhet staf.

Z.Gjergji Nika – Pse turizmi duhet parë me prioritet..Gjërat duhen parë në terren; 17% ra kursi i këmbimit, booking etj.. Tarifatat rriten 37%..Bizneset e turizmit, janë të painformuar. Unë jam kundër, bashkë me grupin tim, të jetë paketë fiskale më e plotë. Është dhe afat i shkurtër..

Z.Ermal Dredha – Në komision ishit dakort. Jemi të gjithë për qytetin.

Z.Grigor Dede – Ndodhemi dhe, në kushtet e zhvillimit ekonomik, të gjitha çmimet po rriten, jo vetëm në Bashkinë Vlorë. Çdo bashki, të ketë autonomi financiare ; 40-50% financime nga granti. Nuk janë bashki me autonomi financiare. Duke bërë një analizë nga buxhetet e mëparshme ..60% pra, nga të ardhurat e veta , duhen për investime. Duhet financuar për këto.

Rritja e taksave dhe tarifave , asnjëherë nuk është e mirë, por është e nevojshme.

-Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat janë rritur, por jo familjet. Janë prekur një pjesë e biznesit.

Një bashki të jetë e fortë financiarisht , duhet të gjejë këto financime. Bashkia Vlorë, nuk është e pavarur financiarisht. Duhet të marrim këto kosto për më shumë shërbime.

Të diferencohet tarifa e pastrimit..(citon ligjin ..., pra nuk mund të bëhen përjashtime)

Z.Klodian Xhyheri – Flet për autonomi financiare, kur 51% e ka AKUMI..Lekët e ujës jellësit Çfarë takse ka zona e jahteve ?

Z.Klaudio Mehmetaj – Nga 4, në 6%.

Z.Klodian Xhyheri - Është zonë super elitare. Të bëhet 8%. Ka një kryetëm për këtë projektvendim, e cila është rritja e taksave, pasi 90% e tyre nuk kanë biznes. Nuk shikoj të bëhet një studim, që a e përballojnë bizneset dot këtë rritje ?

Po e parathem. Do ketë një taksim me parkimet. Rritja është jashtë realitetit të biznesit. Biznesi nuk shihet si partner, por si armik. I jemi qepur tueizmit. Ky sektor do mbështetje të mëdha.

Nëse rrisim taksat dhe tarifatat, do rriten çmimet.

Tarifatat e shërbimit të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit janë shtuar. Është shumë e madhe barra fiskale, ka shpopullim.

Znj.Liljana Breshani – Nuk jam dakort me shpopullimin. Japin informacion të gabuar. Njerëzit lëvizin që me krijimin e shoqërisë njerëzore. Është subjektive.

Z.Klodian Xhyheri – Kjo rritje , nuk e ndihmon biznesin. Do ta votojmë kundër..Bizneset tona po mbyllen ..

z.Ervis Moçka – Duke përgëzuar zotin Nika që falënderoi për punën e bërë për paketën fiskale. Takimet me grupet e interesave janë bërë, njoftimet janë bërë për të bërë prezent kërkesat e tyre. Drafti i parë i administratës , lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, ka qenë 8% , dhe mbas këtyre takimeve , kjo është ulur dhe është pasqyruar në 6%. Është e folur aq shumë me grupet e bizneseve..., e mbrojnë të zotët.

Është diskutuar dhe reflektuar nga 8% në 6%, taksa e ndikimit në infrastrukturë. Sipas zotit Nika për uljen në 2%, nuk mund të bëhet, bazuar në ligj, në caktimin e tavanëve..

Taksa e fjetjes në hotel, duhet bërë dallimi në vlerë dhe procedurë. Taksa ndryshon nga tarifa.

Taksa të jetë dhe rregullator, tarifa kthehet në shërbim. Hoteleritë të dorëzojnë rregjistrin..Në rast se jo, bazuar në ligj dhe në këtë rast i bie puna administratës së bashkisë për kontrolle dhe të veprojë.

Tarifa e pastrimit, që thotë kolonat kjo tarifë duhet të mbulojë kostot..

-17% bizneset

-20% familjet, pra në 37% të kostos .Pra, kur kemi dhe rritje të numrit të punonjësve... Është i pamundur ky shërbim.

KFW deri në vitin 2030, rriten kostot deri në 80%.

Sot është e papranueshme që pastrimi të mbulohet me 17% nga bizneset. Tarifat kthehen në shërbime... SPL

Është një paketë për tu përshëndetur. Faleminderit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 10 vota

Abstenim – 2 vota

Miratohet.

Faleminderit për pjesëmarrjen e sotme në këtë mbledhje.